

**Komisioni Qendror Ndër-Ministror (KQNM)
mbi menaxhimin e fondeve të Qeverisë së Kosovës për renovimin e dëmeve**

PYETJE QË SHTROHEN SHPESH MBI RINDËRTIMET E PAS MARSIT
Njësia nr. 2, 01 Shtator 2004

1. Pyetjet e përgjithshme

Sa shtëpi janë rindërtuar gjer tani dhe sa kanë mbetur për t'u rindërtuar?

Deri më 31 gusht është kryer rindërtimi i 414 shtëpive (shumica e të cilave kanë pësuar dëme më të vogla) dhe 407 janë në rindërtim e sipër. Rreth 116 shtëpi kanë mbetur për t'u rindërtuar, përfshirë shumë shtëpi të cilat ishin krejtësisht të shkatërruara. Kah mesi i tetorit do të përfundojë rindërtimi i shtëpive dhe ndërtesave publike nën program të Komisionit Qendror Ndër-Ministror (KQNM) për rindërtim.

Kur do të fillojë rindërtimi i kishave?

Pas ngjarjeve të marsit u bë vlerësimi i dëmeve të objekteve religjioze dhe kulturore. Tani është formuar një Komision për implementimin e rindërtimit të objekteve religjioze, dhe pritet që rindërtimi i monumenteve religjioze, përfshirë kishat, të fillojë së shpejti.

Shtëpia ime ishte dëmtuar por nuk është futur në listën e Komisionit për rindërtim, çka mund të bëjë unë lidhur me këtë çështje?

Mund ta kontaktoni zyrtarin komunal për komunitete i cili do të shqyrtojë rastin tuaj me Komisionin komunal të rindërtimit dhe do t'ju referojë për rezultatin e arritur.

Unë nuk dua që shtëpia ime të rindërtohet, unë dua të holla, a është kjo mundshme?

Jo. Programi i rindërtimit të KQNM-së mbulon vetëm rindërtimin e shtëpive të dëmtuara dhe shkatërruara gjatë ngjarjeve të marsit. Nuk ekziston një fond për kompensim të drejtëpërdrejt për pasurinë e shkatërruar.

2. Nënshkrimi i dokumenteve ligjore

Pse duhet të nënshkruaj marrëveshtjen tripalëshe, për çfarë shërben ajo?

Para se të fillojë rindërtimi i shtëpisë suaj, ju dhe dy palët tjera (Komisioni komunal për rindërtim dhe Implementuesi Komunal (ekipi për rindërtim të shtëpive ose OJQ-ja) duhet të nënshkruajnë një marrëveshje tripalëshe në bazë të së cilës përcaktohet se çka do të bëhet me shtëpinë tuaj. Kjo garanton se shtëpia juaj do të rindërtohet dhe do të bëhet mu sikur ka qenë më parë. Rindërtimi mund të fillojë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga të tri palët.

A mundet Komuna të fillojë rindërtimin e shtëpisë sime pa nënshkrimin tim në marrëveshjen tripalëshe?

Puna e rindërtimit nuk mund të fillojë para se të nënshkruhet marrëveshja tripalëshe nga të tri palët (implementuesi komunal, pronari dhe Komiteti Komunal për Rindërtim).

A mund ta shes pasurinë time pas kryerjes së procesit të rindërtimit?

Pasi që të mbaroj rindërtimi i shtëpisë suaj, ju mund të bëni çka të doni me shtëpin tuaj, ju mund edhe ta shitni. Nuk ka kurrfarë ndalesë lidhur me pasurinë tuaj.

Pse duhet ta nënshkruaj Çertifikatën e përfundimit të ndihmës? Për çka duhet kjo çertifikatë?

Pasi të kryhet rindërtimi i shtëpisë suaj, të tri palët të cilat e kanë nënshkruar marrëveshtjen tripalëshe duhet ta nënshkruajnë Çertifikatën e përfundimit të ndihmës e cila tregon se rindërtimi është bërë në përputhje me marrëveshtjen tripalëshe. Nëse jeni legjitim për "ndihmën elementare" (shih nenin 4 për më shumë informata lidhur me këtë çështje) ju mund të fitoni këtë ndihmë pasiqë së pari të keni nënshkruar Çertifikatën e përfundimit të ndihmës. Sidoqoftë, ju duhet të nënshkruani çertifikatën mbi përfundimin e ndihmës vetëm pas kryerjes së punëve në shtëpinë tuaj. Nëse keni vërejtje lidhur me atë se punët nuk janë kryer si duhet, ato duhet t'i drejtohen udhëheqsit të projektit. Nëse rezultatet nuk janë të kënaqshme, mund ta kontaktoni zyrtarin komunal për komunitete i cili mund të shqyrtojë këtë çështje me Komisionin komunal për rindërtim.

3. Rindërtimi në veprim dhe rindërtimi i përfunduar

Kush duhet të kujdeset për sigurinë e shtëpisë sime gjatë procesit të rindërtimit?

Kompania ndërtimore që mirret me rindërtimin e shtëpisë suaj është përgjegjëse për sigurinë e shtëpisë suaj gjersa zgjat rindërtimi. Nëse nuk jeni të kënaqur me sigurinë e ofruar për shtëpinë tuaj, duhet të kontaktoni udhëheqsin e projektit. Nëse as kjo nuk ka sukses, atëherë mund t'i referoheni Komisionit komunal për rindërtim.

Kur të kompletohet, kush do të përkujdeset për sigurinë e shtëpisë sime nëse unë nuk jam në gjendje të hyj në të menjëherë?

Kur është kompletuar shtëpia juaj dhe keni nënshkruar çertifikatën e kryerjes së ndihmës, siguria e shtëpisë është nën përgjegjësinë tuaj. Policia do të kujdeset për sigurinë e përgjithshme të zonës, në bazë të mundësive që kanë në dispozicion. Ju duhet të mundoheni të ktheheni në shtëpinë tuaj sa më shpejt që është e mundur. Mund të pyesni Menaxherin e Projektit se kur shtëpia juaj do të kompletohet dhe të planifikoni kthimin tuaj me kohë.

Deshiroj të kthehem në shtëpinë time, por nuk ka orëndi, çfarë duhet të bëj?

Nese shtëpia juaj krejtësisht është plaçkitur apo djegur, ju jeni legjitim për ndihmë elementare. Do t'i merrni 2000 Euro për të blerë orënditë themelore, të mirat dhe enët e kuzhinës për shtëpinë tuaj (shih seksionin 4 për informata më të hollësishme mbi të). Pastaj, do të jeni në gjendje të ktheheni në shtëpinë tuaj shumë shpejt.

Çfarë duhet të bëj nëse nuk jam i kënaqur me kualitetin e punës që është kryer në shtëpinë time? A mundem të ankojem dhe kujt t'i ankojem?

Nese rindërtimi i shtëpisë suaj nuk është në pajtim me Marrëveshjen Tripalëshe që e keni nënshkruar, ju duhet së pari të diskutoni për problemin tuaj me Menaxherin e Projektit. Nëse mendoni se çështja juaj nuk është marrë në konsideratë, mund të kontaktoni Zyrтарin Komunal për Bashkësi i cili mund ta drejtojë atë në Komisionin Komunal për Rindërtim.

Nese kam probleme me shtëpinë time pasi që është përfunduar rindërtimi i saj, kujt mundem t'i drejtohem? A ka ndonjë garancion?

Të gjitha shtëpitë e rindërtura nga KQNM-ja kanë 6 muaj garancion që nga koha kur është nënshkruar çertifikata e kryerjes së ndihmës. Nëse hasni probleme në pjesën e shtëpisë së rindërtuar përmes programit të KQNM-së, mund të raportoni këtë tek Zyrtari komunal për komunitet, i cili do të shtroj këtë problem në Komitetin komunal për rindërtim.

4. Ndihma fillestare***

Kam dëgjuar për ndihmën fillestare: Kush ka të drejtë të marrë atë? Për çka është ajo?

Qeveria ka vendosur se për nevojtarët të cilët orënditë, mallrat dhe veglat shtëpiake iu janë plaçkitur apo shkatërruar nga zjarri do të jenë të pranueshëm për marrjen e parave në shumë prej 2000 Euro si ndihmë për blerjen e orendive, mallrave themelore shtëpiake në mënyrë që të lehtësojë kushtet e jetës në shtëpitë e renovuara/rindërtuara.

Çfarë duhet të bëj për t'i marrë ato? Kur do t'i marr?

Nese jeni të pranueshëm, duhet të plotësoni një formular duke përfshirë detalet si xhirollogarinë bankare që këto para të transferohen në xhirollogarinë tuaj bankare. Një përfaqësues nga Komiteti Komunal për Rindërtim do t'iu kontaktoj në kohën kur ju keni nënshkruar Çertifikatën për kryerjen e Ndihmës. Nëse nuk keni xhirollogari bankare, duhet të hapni një.

A mundem të përdorë këto para siç dua?

Kur e nënshkruani formularin për ndihmë fillestare, ju jeni të obliguar të shpenzoni paratë e dhëna për mallra dhe orëndi shtëpiake për shtëpinë e sapo renovuar/rindërtuar.

Ndihma fillestare nuk do të jetë e mjaftueshme të zëvendësoj të gjitha që kam humbur, a do të ketë ndonjë lloj tjetër ndihme?

Qeveria është e vetëdijëshme se ndihma fillestare nuk do të jetë e mjaftueshme për të kompenzuar të gjitha që keni humbur, por është i vetmi program në vend në këtë çast për të siguruar ndihmë.

A është ndihma fillestare opcioni i vetëm apo mund të ankojem?

Keni të drejtën për t'u ankuar në gjykatën tuaj Komunale.

Kam strehuar familje të zhvendosur për disa muaj, a mund të paguhem për këtë?

Programi i KQNM-së nuk e mbulon këtë. Ai merret vetëm me rindërtim.

5. Ndërtesat dytësore dhe pronat e luajtshme

Kur do të fillon ndërtimi i objekteve dytësore si depove, hangareve dhe garazhave?

Nje vlerësim është në progres dhe do të përcaktojë vendimin e Qeverisë mbi këtë çështje.

A do të kompensohen automjetet e djegura?

Programi i KQNM-së nuk e mbulon këtë. Të vetmet që janë marrë në konsideratë janë mallrat dhe orënditë shtëpiake të cilat krejtësisht janë plaçkitur apo djegur.

A do të më zëvendësohen enët shtëpiake sikurse thikat dhe pirunat?

"Ndihma elementare" mund të përdoret për të zëvendësuar të mirat themelore shtëpiake përfshirë enët e kuzhinës

Ministri Behxhet Brajshori,

Kryesues i Komisionit Qendror Ndërmintor (KQNM)

*** Nëse dëshironi të merrni informata më të hollëshme në lidhje me ndihmën fillestare, Zyrtari Komunal për Komunitete mund t'iu sigurojë Pamfletë Informativë.